UDHËZIM
Nr. 20, datë 17.6.2013

PËR ZBATIMIN E LIGJIT NR. 105/2013, DATË 28.3.2013 "PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 10 083, DATË 23.2.2009 "PËR MIRATIMIN E KONTRATËS SË KONCESIONIT NDËRMJET MINISTRISË SË EKONOMISË, TREGTISË DHE ENERGJETIKËS, SI AUTORITET KONTRAKTUES DHE EVN AG, STATKRAFT AS E DEVOLL HYDROPOWER SHA, SI BASHKËKONCESIONARË PËR PROJEKTIMIN, FINANCIMIN, NDËRTIMIN, MARRJEN NË PRONËSI, SHFRYTËZIMIN, MIRËMBAJTJEN DHE TRANSFERIMIN E PROJEKTIT TË HIDROCENTRALIT NË LUMIN DEVOLL, NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË""

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të nenit 3 të ligjit nr. 105/2013, datë 28.3.2013 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10 083, datë 23.2.2009 "Për miratimin e kontratës së koncesionit ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, si autoritet kontraktues dhe EVN AG, Statkraft AS e Devoll Hydropower sh.a., si bashkëkoncesionarë për projektimin, financimin, ndërtimin, marrjen në pronësi, shfrytëzimin, mirëmbajtjen dhe transferimin e projektit të hidrocentralit në lumin Devoll, në Republikën e Shqipërisë"", të ndryshuar, Ministri i Financave

UDHËZON:

1.1 Importi dhe furnizimi brenda vendit i mallrave dhe i shërbimeve, që lidhen me projektin e hidrocentralit në lumin Devoll, gjatë fazës së parandërtimit dhe fazës së ndërtimit (siç janë përkufizuar në kontratën e koncesionit, të ndryshuar), do t'i nënshtrohen regjimit specifik të tatimit mbi vlerën e shtuar, i cili nënkupton zbatimin e mekanizmit të autofaturimit të TVSH-së për disa furnizime mallrash dhe shërbimesh, siç përcaktohet në ligjin nr. 105/2013 dhe në këtë udhëzim.

1.2 Përkufizime

"Kontraktor i nivelit 1" nënkupton një kontraktor të drejtpërdrejtë të shoqërisë koncesionare, siç është emëruar nga shoqëria koncesionare në përputhje me nenin 2.8.5 të kontratës së koncesionit, të ndryshuar.

"Kontraktor i nivelit 2" nënkupton një kontraktor të drejtpërdrejtë të çdo kontraktori të nivelit 1 siç është emëruar nga shoqëria koncesionare në përputhje me nenin 2.8.5 të kontratës së koncesionit, të ndryshuar.

"Shoqëria koncesionare" nënkupton shoqërinë Devoll Hydropower sh.a. me numër unik të identifikimit të subjektit (NIPT) K82418002C.

Termat e tjerë të përdorur në këtë udhëzim do të kenë të njëjtin kuptim që i është dhënë në kontratën e koncesionit ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, si autoritet kontraktues dhe EVN AG, Statkraft AS e Devoll Hydropower sh.a., si bashkëkoncesionarë për projektimin, financimin, ndërtimin, marrjen në pronësi, shfrytëzimin, mirëmbajtjen dhe transferimin e projektit të hidrocentralit në lumin Devoll, në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.

2.1 Për qëllimin e zbatimit të regjimit specifik të TVSH-së, të përcaktuar në ligjin 105/2013 dhe nenin 2.8 të kontratës së koncesionit, të ndryshuar, shoqëria koncesionare emëron gjithsej deri në dyzet e pesë (45) kontraktorë të nivelit 1 dhe kontraktorë të nivelit 2, me të drejtën që më pas të zëvendësojë çdo kontraktor të nivelit 1 dhe nivelit 2 të emëruar. Kontraktorët e emëruar në çdo periudhë kohore nuk duhet të kalojnë numrin 45.

2.2 Shoqëria koncesionare depoziton pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve listën fillestare të kontraktorëve të nivelit 1 dhe të nivelit 2, si dhe kopje të kontratave që shoqëria koncesionare ka lidhur me çdonjërin nga kontraktorët e nivelit 1 së bashku me kopje të certifikatës NUIS të tyre (për subjektet e regjistruara në Republikën e Shqipërisë), si dhe kopje të kontratave të lidhura mes kontraktorëve të nivelit 1 me kontraktorët e nivelit 2.

Shoqëria koncesionare depoziton pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve edhe listat e përditësuara të kontraktorëve të nivelit 1 dhe të nivelit 2, kohë pas kohe sipas nevojave të aktivitetit, deri sa numri i kontraktorëve në listë të arrijë 45, sipas procedurës së përcaktuar në pikën 2.3. Lista fillestare dhe listat e përditësuara të kontraktorëve të nivelit 1 dërgohen edhe pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave.

2.3 Në rast të ndonjë shtese të kontraktorëve, heqje nga lista apo zëvendësim të kontraktorëve të nivelit 1 dhe të nivelit 2 brenda numri 45, shoqëria koncesionare duhet të paraqesë tek administrata tatimore listën e përditësuar. Këto ndryshime bëhen efektive tri javë pas dërgimit të listës së përditësuar. Lista do t'u dërgohet Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve (DPT) dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, rast pas

rasti.

Me bërjen efektive të shtesës, heqjes nga lista apo zëvendësimit në listën e përditësuar, kontraktori i çregjistruar nga lista në fjalë për efekte të TVSH-së nuk është më objekt i regjimit specifik të TVSH-së, të rregulluar me ligjin nr. 105/2013, por i nënshtrohet tërësisht dispozitave të ligjit për TVSH-në në fuqi.

Një kontraktor i nivelit 1 ose nivelit 2 që hiqet nga lista nga ana e shoqërisë koncesionare, mund të riemërohet dhe përfshihet në listë nga shoqëria koncesionare në përputhje me dispozitat e ligjit nr. 105/2013 dhe këtij udhëzimi.

2.4 Nëse shoqëria koncesionare kërkon shtimin e kontraktorëve të rinj, përveç 45 (dyzet e pesë) kontraktorëve të përmendur më lart, ajo duhet t'i drejtohet Drejtorisë së Kontrollit pranë DPT-së për të miratuar kontraktorët e rinj, duke paraqitur një kërkesë të argumentuar mbi nevojën e shtimit të kontraktorëve të rinj dhe duke i bashkëlidhur kësaj kërkese edhe kopje të kontratës së lidhur mes palëve.

Drejtoria e Kontrollit Tatimor pranë DPT-së, për dhënien e miratimit bashkëpunon me drejtoritë rajonale tatimore që administrojnë kontraktonin e ri. DPT-ja i kthen përgjigje shoqërisë koncesionare brenda 4 javëve nga paraqitja e kërkesës. DPT-ja nuk mund të refuzojë dhënien e miratimit në mënyrë të paarsyeshme.

2.5 Nëse shoqëria koncesionare vendos për zëvendësimin e ndonjërit nga kontraktorët shtesë (mbi numrin 45) me një kontraktor tjetër, ajo i drejtohet Drejtorisë së Kontrollit pranë DPT-së për të miratuar zëvendësimin me kontraktonin e ri. Në kërkesën për këtë zëvendësim, shoqëria koncesionare për çdo rast duhet të shprehet edhe mbi arsyet e kërkesës për zëvendësimin e kontraktonit të mëparshëm.

Edhe në këtë rast, Drejtoria e Kontrollit Tatimor pranë DPT-së, për dhënien e miratimit bashkëpunon me drejtoritë rajonale tatimore që administrojnë kontraktonin e ri dhe kontraktonin e zëvendësuar. DPT-ja i kthen përgjigje shoqërisë koncesionare brenda 4 javëve. DPT-ja nuk mund të refuzojë dhënien e miratimit në mënyrë të paarsyeshme. Me bërjen efektive të zëvendësimit në listën e parashikuar, kontraktori i çregjistruar nga lista në fjalë për efekte të TVSH-së nuk është më objekt i regjimit specifik të TVSH-së, të rregulluar me ligjin nr. 105/2013, datë 28.3.2013, por u nënshtrohet tërësisht dispozitave të legjislacionit të përgjithshëm për TVSH-në në fuqi.

3.1 Importimi gjatë fazës së parandërtimit dhe fazës së ndërtimit të të gjitha makinerive dhe pajisjeve, linjave teknologjike, automjeteve, lëndëve të para, pjesëve të këmbimit dhe çdo malli tjetër që lidhet me projektin, në atë masë që këto importe nuk janë të përjashtuara sipas ligjit të TVSH-së dhe akteve nënligjore në zbatim të tij, importuesi nuk do të ketë detyrim për pagesën e tatimit mbi vlerën e shtuar pranë autoriteteve doganore, që duhej kryer në lidhje me këto importe. Pra, për importimin e mallrave që nuk janë të përjashtuara në bazë të dispozitave të ligjit të TVSH-së dhe akteve nënligjore të tij, do të zbatohet regjimi specifik i TVSH-së, i përcaktuar në ligjin nr. 105/2013 dhe në këtë udhëzim.

Ky import mallrash do të trajtohet si një furnizim mallrash i kryer nga importuesi për veten e tij, si pjesë e veprimtarisë së tij ekonomike, me efekt lindjen e detyrimit të importuesit për të paguar këtë tatim mbi vlerën e shtuar ndaj administratës tatimore dhe të drejtën e tij për të zbritur këtë tatim mbi vlerën e shtuar.

Kjo pikë zbatohet vetëm ndaj importeve të kryera nga shoqëria koncesionare ose çdo kontraktor i nivelit 1.

3.2 Importuesi, sipas pikës 3.1 më sipër, do të lëshojë një faturë tatimore shitjeje për veten, ku do të rezultojë si furnizues dhe blerës i mallrave në të njëjtën kohë (autofaturim) dhe ka të drejtë që në mënyrë të menjëhershme të zbresë nga TVSH-ja e llogaritur mbi shitjet që i korrespondojnë këtyre importeve, TVSH-në e zbatuar në këto blerje në të njëjtën shumë, pra nuk do të bëhet një pagesë me para në dorë pranë administratës tatimore, me kusht që importuesi të ketë të drejtë të zbresë këtë TVSH në blerje sipas dispozitave të përgjithshme të ligjit të TVSH-së.

Fatura tatimore e përgatitur sipas kësaj pike regjistrohet njëkohësisht në librin e blerjes dhe atë të shitjes së TVSH-së. Konkretisht, vlera e tatueshme dhe TVSH-ja në import do të paraqitet në librin e shitjes në kolonat [11] dhe [12] "Shitje brenda vendit". Po kjo faturë do të deklarohet në librin e blerjes në kolonat [20] dhe [21] "Blerje nga furnitorë vendas me shkallë tatimore 20%".

Po ashtu, vetëm për qëllime të evidentimit të importit të kryer, dokumenti i vetëm administrativ përkatës do të regjistrohet dhe deklarohet në librin e blerjeve në kolonën [15] "Blerje të përjashtuara, me TVSH jo të zbritshme dhe pa TVSH" me ngjyrë të kuqe, por nuk do të merret në konsideratë në përllogaritjen e blerjeve të shoqërisë koncesionare apo kontraktorit të nivelit 1.

3.3 Shoqërisë koncesionare apo kontraktorit të nivelit 1 i lëshohet deklarata doganore (DAV) e importit (IM4) me një numër regjistrimi R. Në kutinë nr. 37 të DAV-it, vendoset kod shtesë për (regjimin

specifik të TVSH-së sipas ligjit 105/2013). Në kutinë nr. 47 (llogaritja e detyrimeve) të DAV-it, kolona MP, në zërin TVSH shënohet një numër i veçantë nga administrata doganore, që nënkupton mospagimin e TVSH-së në çastin e importimit. Kështu, në totalin e detyrimeve që duhen paguar paraqitet vetëm shuma e detyrimeve doganore.

Për çdo regjistrim vendoset dukshëm, në çastin e kryerjes së importit shënimi "Import sipas regjimit specifik të TVSH-së sipas ligjit nr. 105/2013, referuar deklaratës doganore nr. ___/datë___".

3.4 Kontraktori i nivelit 1 ose shoqëria koncesionare sipas këtij udhëzimi, kur kryen veprime për herë të parë pranë autoriteteve doganore paraqet:

a) një kërkesë me shkrim për zbatimin e dispozitave të këtij udhëzimi;

b) fotokopje të certifikatës së NUIS;

c) kopje të kontratës së lidhur me shoqërinë koncesionare, ku jepen detaje për mallrat, sasitë dhe degët e kontraktonit 1, që janë potencialisht furnizuese të mallit që do të importohen.

3.5 Trajtimi i importeve, siç përcaktohet më sipër në pikat 3.1 deri 3.4, nuk ndikon tek e drejta e importuesit për të zbritur TVSH-në në blerje (mbi bazën e autofaturës së lëshuar prej tij në përputhje me pikën 3.2 më sipër) njësoj sikur importi i kryer prej tij të ishte një importim i tatueshëm me TVSH, sipas rregullave të përgjithshme të TVSH-së.

4.1 Për shërbimet e lidhura me projektin, duke përfshirë këtu edhe shërbimet që lidhen me pasurinë e paluajtshme që ndodhet në Shqipëri, të cilat janë subjekt i TVSH-së në Republikën e Shqipërisë, që kryhen nga furnitorë të huaj, persona të tatueshëm që nuk kanë vend të veprimtarisë ekonomike në Shqipëri dhe të cilët nuk janë të regjistruar për qëllim të deklarimit dhe pagesës së TVSH-së pranë administratës tatimore në Shqipëri, të kryera nga vetë furnitori i huaj ose dega e saj për shoqërinë koncesionare ose për një kontraktor të nivelit 1, gjatë fazës së parandërtimit dhe fazës së ndërtimit, vetëm personi, të cilit i janë furnizuar shërbimet do të jetë përgjegjës për pagesën pranë administratës tatimore të çdo tatimi mbi vlerën e shtuar, që është i detyrueshëm për t'u paguar në lidhje me këto shërbime.

Këto shërbime do të trajtohen si shërbime të kryera nga personi, të cilit i janë furnizuar shërbimet, për veten e tij si pjesë e veprimtarisë së tij ekonomike (autofaturim), me efekt lindjen e detyrimit të personit, të cilit i janë furnizuar shërbimet për të deklaruar si të pagueshëm tatimin mbi vlerën e shtuar ndaj administratës tatimore dhe të drejtën e tij për ta zbritur këtë tatim mbi vlerën e shtuar, përveçse kur zbritja (kreditimi) i tatimit nuk lejohet sipas dispozitave të përgjithshme të ligjit për TVSH-në. Pra, gjatë fazës së parandërtimit dhe fazës së ndërtimit, shoqëria koncesionare ose kontraktori i nivelit 1 do të jenë përgjegjës për llogaritjen dhe deklarimin e TVSH-së për shërbimet e marra përfshirë edhe shërbimet që lidhen me pasurinë e paluajtshme që ndodhet në Shqipëri, të lidhura me projektin, të cilat janë subjekt i TVSH-së në Republikën e Shqipërisë dhe që kryhen nga tatimpagues të paregjistruar në Shqipëri, pa pasur nevojën që këta të fundit të regjistrohen vetë në Shqipëri apo të emërojnë një përfaqësues tatimor në Shqipëri, për efekt të deklarimit dhe pagesës së TVSH-së.

5.1 Për furnizimet brenda vendit të makinerive dhe pajisjeve, linjave teknologjike, automjeteve, lëndëve të para, pjesëve të këmbimit dhe çdo malli tjetër të lidhura me projektin, si edhe të të gjitha shërbimeve, të lidhura me projektin gjatë fazës së parandërtimit dhe fazës së ndërtimit, vetëm personi, të cilit i janë kryer furnizimet do të jetë përgjegjës për deklarimin si të pagueshëm të TVSH-së pranë administratës tatimore të çdo tatimi mbi vlerën e shtuar, që është i detyrueshëm për t'u paguar në lidhje më këto furnizime dhe do të ketë të drejtë ta zbresë këtë tatim mbi vlerën e shtuar nëpërmjet procesit të autofaturimit, në përputhje me dispozitat e ligjit për TVSH-në. Në këtë rast në faturat e lëshuara nga furnizuesi për furnizimet, nuk llogaritet apo pasqyrohet TVSH-ja. Trajtimi në këtë mënyrë i furnizimeve, nuk ndikon tek e drejta e furnizuesit për të zbritur TVSH-në në blerje njësoj sikur furnizimi i tij të ishte një furnizim i tatueshëm me TVSH, sipas rregullave të përgjithshme të TVSH-së.

Kjo procedurë është e zbatueshme vetëm për furnizime të kryera nga kontraktorët e nivelit 1 dhe kontraktorët e nivelit 2.

Përfituesi i këtyre furnizimeve, që sipas rastit do të jetë shoqëria koncesionare ose kontraktori i nivelit 1, do të lëshojë një faturë tatimore shitjeje për veten ku do të rezultojë si furnizues (shitës) dhe blerës i mallrave dhe i shërbimeve në të njëjtën kohë (autofaturim) dhe ka të drejtë që në mënyrë të menjëhershme të zbresë nga TVSH-ja e llogaritur mbi shitjet që i korrespondojnë këtyre furnizimeve të mallrave ose shërbimeve, TVSH-në e zbatuar në këto blerje në të njëjtën shumë, pra nuk do të bëhet një pagesë me para në

dorë pranë administratës tatimore, me kusht që personi, të cilit i janë kryer furnizimet, të ketë të drejtë të zbresë këtë TVSH në blerje sipas dispozitave të përgjithshme të ligjit për TVSH-në.

5.2 Furnizimet e kryera ndërmjet një pale të tretë dhe një kontraktori të nivelit 2 kur ky i fundit është përfituesi (blerësi) i mallrave apo i shërbimeve dhe, pavarësisht nëse ato janë të lidhura me projektin apo kryhen gjatë fazës së parandërtimit dhe fazës së ndërtimit, nuk janë subjekt i regjimit specifik të TVSH-së sipas këtij udhëzimi. Këto furnizime iu nënshtrohen dispozitave të ligjit për TVSH-në dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij.

5.3 Për furnizimet e kryera nga kontraktori i nivelit 2 ndaj kontraktorit të nivelit 1, kontraktori i nivelit 2, do të lëshojë një faturë tatimore, duke mos llogaritur apo deklaruar TVSH-në në faturë, pasi furnizimet e kryera nga kontraktori i nivelit 2 janë të tatueshëm me TVSH, por detyrimin për llogaritjen, deklarimin dhe pagesën e TVSH-së për këto furnizime e mban përfituesi (blerësi) i këtyre furnizimeve. Kontraktori i nivelit 2 do ta regjistrojë faturën e shitjeve në librin e shitjeve në kolonën [10] “Eksporte/furnizime me 0%”.

5.4 Për vlerën e furnizimeve të furnizuara nga kontraktori i nivelit 2, sipas faturës së lëshuar në përputhje me paragrafin 5.3, kontraktori i nivelit 1 do të lëshojë një faturë tatimore shitje për veten ku do të rezultojë si furnizues (shitës) dhe blerës i mallrave dhe i shërbimeve në të njëjtën kohë (autofaturim). Vlerën e tatueshme dhe TVSH-në e paraqitur në këtë faturë, kontraktori i nivelit 1 do ta deklarojë në librin e blerjes përkatësisht në kolonën [20] dhe [21] “Blerje brenda vendit me shkallë tatimore 20%”, me kusht që kontraktori i nivelit 1 ka të drejtë të zbresë këtë TVSH në blerje sipas dispozitave të përgjithshme të ligjit për TVSH-në. Në të njëjtën kohë vlera e tatueshme dhe TVSH-ja do të deklarohen në librin e shitjes në kolonën [11] dhe [12] “Shitje brenda vendit me shkallë tatimore 20%”.

5.5 Vetëm për qëllime të evidentimit dhe të rakordimit nga administrata tatimore, fatura tatimore e lëshuar nga kontraktori i nivelit 2 do të regjistrohet dhe deklarohet në librin e blerjeve të kontraktorit të nivelit 1 në kolonën [15] “Blerje të përjashtuara me TVSH jo të zbritshme dhe pa TVSH”, me ngjyrë të kuqe, por nuk do të merret në konsideratë në përllogaritjen e blerjeve totale të kontraktorit të nivelit 1.

5.6 E njëjta procedurë do të zbatohet për furnizimet e kontraktorit të nivelit 1 të kryera për shoqërinë koncesionare. Në faturën e lëshuar nga kontraktori i nivelit 1 për shoqërinë koncesionare nuk do të llogaritet dhe pasqyrohet TVSH-ja. Kontraktori i nivelit 1 do të deklarojë këtë faturë në librin e shitjeve në kolonën [10] “Eksporte/furnizime me 0%”. Shoqëria koncesionare do të lëshojë faturë tatimore shitjeje për vete (autofaturim), e cila do të deklarohet në librat e TVSH-së, siç përcaktohet në paragrafin 5.4 më sipër.

5.7 Trajtimi i furnizimeve, siç përcaktohet në pikat 5.1 deri 5.8, nuk ndikon tek e drejta e furnizuesit për të zbritur TVSH-në në blerje njësoj sikur furnizimi i tij të ishte një furnizim i tatueshëm me TVSH sipas dispozitave të përgjithshme të ligjit për TVSH-në.

6. Faturat shtesë (saktësuese) të lëshuara në përputhje me nenin 29 të ligjit për TVSH-në do të trajtohen në të njëjtën mënyrë dhe procedurë, si dhe faturat për furnizimin e mallrave dhe shërbimeve të përmendura në paragrafët 3, 4 dhe 5 të këtij udhëzimi. Faturat e lëshuara në zbatim të nenit 13 të ligjit për TVSH-në për paradhënie do të trajtohen në të njëjtën mënyrë dhe procedurë, si edhe faturat për furnizimin e mallrave dhe shërbimeve të përmendura në paragrafët 4 dhe 5 të këtij udhëzimi.

7. Shoqëria koncesionare, kontraktori i nivelit 1 apo kontraktori i nivelit 2 nëse kryejnë furnizime të mallrave apo shërbimeve për palë të treta për të cilat nuk zbatohet regjimi specifik i TVSH-së, siç përcaktohet në këtë udhëzim, do të lëshojnë faturë tatimore në përputhje me dispozitat e ligjit për TVSH-në.

8. Nëse furnizimet brenda vendit të mallrave apo të shërbimeve të kryera nga kontraktori i nivelit 1 apo kontraktori i nivelit 2 janë të përjashtuara nga TVSH-ja sipas dispozitave të ligjit për TVSH-në (përveç furnizimit të përcaktuar në pikën 2.C të shtesës së 2-të të kontratës së koncesionit, të miratuar me ligjin 105/2013), atëherë për këto furnizime nuk zbatohen dispozitat e këtij udhëzimi, pra ky shërbim nuk autofaturohet nga përfituesi i furnizimit.

9. Ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave për marrjen e masave për zbatimin e këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I FINANCAVE
Ridvan Bode